



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NNSH Vizion Project" të datës 26.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi - Art & Technology Hub - Tulltorja" me nr. të prokurimit 616-23-8833-4-1-3, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NNSH Vizion Project" të datës 26.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi - Art & Technology Hub - Tulltorja" me nr. të prokurimit 616-23-8833-4-1-3.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "NNSH Vizion Project" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NNSH Vizion Project" (tutje "parashtruesi") me datë 26.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi - Art & Technology Hub - Tulltorja" me nr. të prokurimit 616-23-8833-4-1-3.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se poentimi i komisionit vlerësues për parshtruesin ka qenë i pamjaftueshëm lidhur me kriterin hapësinor, programor, ekonomik, estetik dhe ekologjik.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet cekur se kriteret vlerësuese janë përcaktuar nga njësia kërkuuese në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit. Vlerësimi në këtë rast është bërë nga juria e përbërë nga anëtarët profesional të fushës të cilët vlerësimin e kanë bërë në mënyrë objektive dhe në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP. Me fjalë të tjera ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave është realizuar në mënyrë profesionale dhe objektive sipas ligjit në fuqi. Në anën tjetër parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim vetëm pretendon se është dashur të vlerësohet më shumë në kriteret e caktuara mirëpo nuk ka paraqitur asnjë argument i cili sipas LPP apo sipas DT do të provonte se vlerësimi i komisionit në këtë rast nuk është i saktë ose i drejtë. Rrjedhimisht është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.12.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.